

„Forcimi i kapacitetit institucional të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në rrugën drejt anëtarësimit të saj në SEBQ“


❖ Çfarë ndodhi midis 15 shtatorit dhe 14 dhjetorit të vitit 2020?

Në tremujorin e pestë të projektit, nga 15 shtatori deri më 14 dhjetor të vitit 2020 (muaji 13-15 i projektit), u organizuan me sukses dhe u kryen në mënyrë virtuale nëntë misione ekspertësh. Në aktivitetet e përfunduara është përfshirë edhe Bordi i pestë Drejtues i projektit i cili u mbajt në mënyrë virtuale më 1 tetor të vitit 2020

Komponenti 1. SHËRBIMET DHE SISTEMET E PAGESAVE

Në tremujorin e pestë të Projektit, u zhvilluan tre misione virtuale.

Në kuadër të aktivitetit të dytë të këtij komponenti „Harmonizim i mëtejshëm i kornizës së politikave të shërbimeve të pagesave në BPRM me direktivat dhe rregullativat e BE-së në fushën e shërbimeve të pagesave“, ekspertë nga banka qendrore e Lituanisë zhvilluan një mision për temën „Inovacionet financiare dhe mbrojtja e konsumatorëve“ në të cilën ata kryen një analizë të hendeut të harmonizimit të akteve ekzistuese nënligjore në Maqedoninë e Veriut me legjislacionin e BE-së dhe prezantuan përvojën e institucioneve në fushën e inovacioneve, mbrojtjen e konsumatorëve, financimit grupor



(crowdfunding), huadhënies midis personave (p2p), procesit të mbikëqyrjes së ofruesve të rinj të shërbimeve dhe zbatimi i bankingut të hapur.

Kolegët lituanëz duke prezantuar tendencat e FINTECH në vide konferencën e hapur për publikun me më shumë se 60 pjesëmarrës jashtë BPRMV-së

Gjatë misionit të dytë në kuadër të aktivitetit „Forcimi i kapacitetit institucional në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit

(AML/CFT)“, ekspertë nga banka qendrore e Sllovakisë zhvilluan një mision virtual për „Implementimin e përvojave më të mira të BE-së/SEBQ-së për rolin operativ të bankës qendrore në lidhje me AML/CFT“.

Gjatë misionit të tretë të zhvilluar në Komponentin 1, në kuadër të aktivitetit „Përmirësimi i kapacitetit në çështjet e biznesit dhe informatikës lidhur me shlyerjen bruto në kohë reale (MIPS), veçanërisht në TARGET2 dhe TIPS, dhe ISO20022 të zbatuar në sistemet e pagesave në Evropë“, diskutimi kryesor ishte në lidhje me shërbimet TARGET2 dhe TIPS dhe miratimin e ISA20022 dhe ndikimi i tij mbi sistemin MIPS të BPRMV-së. Ky mision u zhvillua nga ekspertë të bankës qendrore të Belgjikës, bashkë me liderin e vendit anëtarë të këtij komponenti nga Bundesbank.

Komponenti 2. RREGULLORJA BANKARE DHE MBIKËQYRJA

Në aktivitetin e tretë në kuadër të Komponentit 2, „Krijimi i kushteve për përmirësimin e mbledhjes së borxheve, menaxhim më të mirë dhe shlyerjen e kredive me probleme dhe përmirësim të administrimit me rrezikun e përgjithshëm të bankave“, dy misionet virtuale u zhvilluan nga ana e ekspertëve nga banka qendrore e Kroacisë.

Gjatë misionit të parë, u analizuan dhe shqyrtuan të dhënat për pozicionin momental të nivelit dhe strukturës së kredive me probleme në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjithashtu u sigurua dhe analizua dokumentacioni për kornizën e nevojshme ligjore për shlyerjen e kredive me probleme, dhe gjithashtu u identifikuan disa lëshime dhe mospërputhje me rregullativat e BE-së. Gjithashtu u prezantua dhe shqyrtua zhvillimi i rregullativës në Kroaci lidhur me kreditë me probleme.

Në misionin e dytë radhazi, përfaqësuesve të BPRMV-së, u prezantuan gjithashtu zgjidhjet e miratuara në Republikën e Kroacisë për të ulur kostot/kreditë me probleme, duke përfshirë ndikimin sasior të këtyre zgjidhjeve. Në mënyrë thelbësore u mbuluan dhe diskutuan mjetet kryesore rregulluese të BPRMV-së për raportim, menaxhim dhe zvogëlimin e kredive me probleme, u identifikuan zonat më të dobëta, ndërsa ekspertët nga banka e Kroacisë dhanë sugjerime për përmirësim.


Komponenti 3. STATISTIKA E LLOGARIVE FINANCIARE

Në këtë tremujor u zhvillua **një mision virtual** nga ana e ekspertëve të bankës qendrore të Kroacisë.

Gjatë „Misionit teknik të transferimit të sistemit për përgatitje të llogarive financiare nga banka qendrore e Kroacisë në BPRMV“, ekspertë të bankës qendrore të Kroacisë bashkë me kolegët e vendit përfitues kryen transferimin e IT zgjidhjeve për përgatitje të llogarive financiare nga BQK-ja në IT njësinë e BPRMV-së.

Lideri i komponentit të shtetit anëtar bashkë me IT ekspertë nga BQK-ja që e ka dizajnuar dhe prodhuar këtë IT zgjidhje, ndanë njohuri dhe siguruan mbështetje teknike për implementimin e sistemit kroat për përgatitje të llogarisë financiare vjetore dhe tremujore. Ky mision u finalizua me testimin e zgjidhjes, prezantimin e procesit të përgjithshëm dhe sigurimin e disa rekomandimeve për zhvillim të ardhshëm dhe përmirësimin e mundshëm të IT zgjidhjes së zbatuar.

Komponenti 4. NJOHURI DHE AFTËSI NË ANALIZËN E POLITIKAVE



Hulumtuesit e BPRMV-së me Liderin e Komponentit 4 duke prezantuar „DSGE model me fërkime financiare për ekonominë maqedonase“ në Konferencën e parë Ndërkombëtare Shkencore në organizim të Fakultetit Ekonomik në Shkup (online).

SHËNIM:

Shëndeti dhe mirëqenia e pjesëmarrësve në projekt janë të një rëndësie të madhe. Duke pasur parasysh situatën e imponuar nga pandemia, Komisioni Evropian vazhdon mundësinë për zhvillimin e misioneve në mënyrë virtuale deri më 30 qershor të vitit 2021.

Kontakt për më shumë informacione: Zyra e Këshilltarit të Përhershëm për Binjakëzim - twinning.nbrnm@gmail.com



НАРОДНА БАНКА НА
РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Projekt i financuar nga Bashkimi Evropian

Institucione për implementim

Institucioni përfitues

Ky publikim është përgatitur me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e BPRMV-së dhe në asnjë mënyrë nuk i reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Gjatë kohës së tremujorit të pestë të projektit, **tre misione virtual** u zhvilluan nga ana e ekspertëve nga Banka Qendrore e Rumanisë; dy për zhvillimin e modelit dhe një për paraqitjen e gjendjes aktuale të modelit dhe rezultatit të konferencës ndërkombëtare.

Gjatë misionit të parë, u diskutua pasqyra e kalibrit të bërë paraprakisht dhe u përfundua se duke pasur parasysh zhvillimet e fundit të të dhënave, ekziston nevoja për azhurnimin e tyre. Ishte kryer një vlerësim bejzian për nëngrupet e ndryshme të parametrit, në mënyrë që të tregohen problemet e mundshme që mund të paraqiten gjatë procesit të vlerësimit.

Në misionin e dytë u rishikua gjendja aktuale e modelit si dhe zhvillimet e fundit në drejtim të koordinimit, parametrave dhe të dhënave. Për më tepër, u bënë rekomandime për disa variable që nuk ishin subjekt i analizës (boshllëqet e PBB-së dhe komponentët e PBB-së, kursi i këmbimit dhe PBB-ja e mundshme) që dalin nga modeli për parashikim tremujor i cili rregullisht përdoret nga BPRMV-ja, përveç atyre të imponuara nga vlerësimi i modelit me përdorimin e teknikave bejziane dhe vlerave paraprake endogjene,

Në misionin e tretë, ekspertët e BPRMV-së, me ndihmën dhe mentorimin e një eksperti nga një shtet anëtar morën pjesë dhe zhvilluan një prezantim të rezultateve gjysmëfinale të modelit dhe punimit hulumtues, me titull „DSGE model me fërkime financiare për ekonominë maqedonase“ në konferencën e parë ndërkombëtare shkencore me temë „Tendencat ekonomike dhe të biznesit që formojnë të ardhmen“ në organizim të Fakultetit Ekonomik të Universitetit Shën. Kirili dhe Metodi në Shkup. Konferenca u mbajt më 12-13 nëntor, në video format, për shkak të kushteve të imponuara nga pandemia e Kovid-19, ndërsa prezantimi i modelit u zhvillua më 12 nëntor.